

Dokumentacioni i nevojshëm për pajisjen me Deklaratë Paraprake Punimesh

- Referuar **Ligjit 107/2014 datë 01.10.2014** “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 41, përcakton se, *ndërrhyrjet jothelbësore në objekt, të natyrës së përkohshme së instalimeve ose rregullimit të kontrollit të zhvillimit nga një leje apo autorizim tjetër apo nga legjislacioni i posaçëm sektorial, nuk kërkojnë pajisjen me një leje ndërtimi dhe janë objekt i një deklaratë paraprake për kryerje punimesh.*

- Në **VKM Nr. 408, Datë 13.5.2015**, “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar me **VKM nr. 271, datë 06.04.2016**, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar”, **VKM nr. 231, datë 21.03.2017**, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar” dhe **VKM Nr. 355, datë 19.04.2017**, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar”, Neni 8, përcakton dokumentacionin e nevojshëm për që duhet të depozitojë personi i interesuar pranë autoritetit vendor për njoftimin e deklaratës paraprake për kryerje punimesh, të cilat janë:
 - a) *Formulari i deklaratës, sipas rregullores së zhvillimit dhe formatit të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve;*

 - b) *Dokumenti që vërteton pronësinë apo të drejtat e ligjshme të deklaruesit mbi pasurinë në të cilën kryhen punimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë kontratë sipërmarrjeje/ porosie, leje legalizimi e të ngjashme.*

 - c) *Projekti teknik i realizimit të punimeve, i firmosur nga projektues të licencuar.*